



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr.823 Prot

Tiranë, më 26/4/2023

REKOMANDIM

Nr.26, datë 26/4/2023

**PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT,
FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE**

Në mbështetje të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <https://www.akafp.gov.al/>, të Autoritetit Publik/ Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (në vijim “Autoriteti Publik”).

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (në vijim “LDI”), kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike e këtij informacioni.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.

Në zbatim të gërmës “c”, pika 2 e nenit 4, nenit 5 dhe 6 të LDI, Zyra e Komisionerit ka miratuar Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij me informacion dhe dokumentacion publik.

Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas Urdhrit nr.187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Nisur nga rëndësia që paraqet arsimi, Zyra e Komisionerit ka vendosur në fokus të punës së saj për vitin 2023, monitorimin e transparencës proaktive të Autoriteteve Publike në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës pranë Zyrës së Komisionerit, kreu monitorimin on-line të faqes zyrtare të Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të rishikuar të transparencës.

Nga monitorimi i kryer në menunë e faqes zyrtare <https://www.akafp.gov.al/rreth-nesh/programi/>, Autoriteti Publik, në rubrikën “Rreth nesh”, ka publikuar “Programin e Transparencës”.

Specifikisht, është publikuar informacion pjesërisht rreth autoritetit, kuadrit ligjor rregullator, e drejta për t’u informuar, koordinatori për të drejtën e informimit, (emër/mbiemër, e-mail, adresa, orari), planet strategjike të punës, buxheti, raportet vjetore të zbatimit të buxhetit, lista e kontratave të lidhura, koordinatori për konsultimin me publikun, lista e dokumenteve që administrohen me afatet e ruajtjes, njoftime të ndryshme, njoftime për procedurat e rekrutimit, si dhe raporte të cilat nuk janë të ndërlidhura me programin e transparencës, ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP.

Bazuar në monitorimin e kryer, Zyra e Komisionerit konstaton mosvënien në zbatim të Programit të Transparencës, në përputhje me pikën 1 të nenit 7 të LDI, urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar të Komisionerit.

Zyra e komisionerit konstaton se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve është publikuar në programin e transparencës, si dhe një pjesë e tyre edhe në faqen zyrtare, por nga ana tjetër vërejmë se ky informacion nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës së Autoritetit Publik, si dhe nuk është përditësuar.

Konkretisht rezultojnë mangësi në rubrikat e mëposhtme:

Rreth Autoritetit

- Paga e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP (përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve

Kuadri ligjor rregullator

- Legjislacion ndërkombëtar
- Akte nënligjore (nuk janë ndërlidhur me programin e transparencës)
- Rregulloret (nuk janë ndërlidhur me programin e transparencës)
- Kodi i sjelljes
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit
- Strategji
- Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun

E drejta për tu informuar

- Nr. i kontaktit i koordinatorit

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP

- Rezolute Kuvendi
- Raporte monitorimi/auditimi të KLSH-së
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës

Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të autoritetit publik

- Donacione, sponsorizime (sipas viteve)
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat

- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik
- Informacion mbi monitorimin e kontratave
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i përditësuar

Shërbimet që ofrohen nga AP

Rregjistri i kërkesave dhe Përgjigjeve

- Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrimit të miratuar nga Komisioneri)

Informacion/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun

- Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil, nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës
- Raportet nuk janë ndërlidhur me programin e transparencës
- Publikime, statistika, projekte dhe bashkëpunime

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht se një pjesë e konsiderueshme e informacionit publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet t'i përmbahet informacionit sipas Programit të Transparencës të Rishikuar miratuar me urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të ndryshuar, sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij rekomandimi.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës së autoriteteve publike dhe çdo autoritet është i detyruar ligjërisht t'a zbatojë atë.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të përditësojë, ndërlidhë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 të këtij rekomandimi.
2. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, "Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me Komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre", të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijani.
3. Në zbatim të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, pas përfundimit të afatit të mësipërm, Komisioneri do të nisë hetimin administrativ.

4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 26.4.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Lidhja nr.1

Raport i monitorimit për zbatimin e programit institucional të transparencës, bazuar në Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Autoritetin Publik/ **Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.**

Prill 2023

Ky raport monitorimi merr në konsideratë vetëm publikimin e informacioneve të cilat janë të ndërlidhura me programin e transparencës sipas Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”.


1	Rreth Autoritetit	
	Struktura organizative/Organigrama	Po
	Struktura e pagave	Po
	Funksionet dhe detyrat e AP	Po
	CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre dhe procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime.	Vetëm CV e drejtorit, jo paga
	Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve	Jo
2	Kuadri ligjor rregullator	
	Legjislacion ndërkombëtar	Jo
	Legjislacion kombëtar	Po
	Akte nënligjore	Po, por nuk i ndërlidh në PT
	Rregullore	Po, por nuk i ndërlidh në PT
	Kodi i sjelljes	Jo
	Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit	Jo

	Strategji	Jo
	Raport vjetor	Po
	Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun	Jo
3	E drejta për tu informuar	
	Koordinatori / Emri mbiemri	Po
	E-mail	Po
	Nr. i gjelbër	Jo
	Tel:	Jo
	Adresa:	Po
	Orari:	Po
	Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)	Po
	Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)	Po
4	Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP	
	Rezolute Kuvendi	Jo
	Planet strategjike të punës	Po
	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	Jo
	Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës	Jo
5	Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të autoritetit publik	
	Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve)	Po
	Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve)	Po
	Donacione, sponsorizime (sipas viteve)	Jo
	Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara	Jo
6	Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat	
	Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)	Po

	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik	Jo
	Informacion mbi monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme	Jo
	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i përditësuar	Jo 2023
7	Shërbimet që ofrohen nga AP	Jo
	Tarifat përkatëse	
	Formular aplikimi	Jo
	Afati kohor	Jo
	Procedura aplikimi	Jo
	Standartet për cilësinë e shërbimit	Jo
8	Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP	AP nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore
	Njoftimi dhe konsultimi publik (Linku)	-
	Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi	-
	Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve	-
	Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes	-
	Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP	-
	Emër mbiemër koordinatori për konsultimin me publikun, adresë postare /elektronike	Po
9	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve	
	Lista e dokumenteve që administrohen nga PP me afatet e ruajtjes	Po
	Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)	Jo
10	Rregjistri i kërkesave dhe Përgjigjeve	
	Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)	Jo

	Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuara për AP që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet)	Jo
11	Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP	AP nuk e ofron këtë shërbim
	Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP	-
	Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve	-
	Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim	-
	Procedura e ankimimit	-
12	Informacion/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun	
	Njoftime të ndryshme	Po
	Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimimit në shërbim civil	Po, por nuk i ndërlihd në PT
	Raporte	Po, por nuk i ndërlihd në PT
	Publikime	Jo
	Statistika	Jo
	Projekte	Jo
	Bashkëpunime etj.	Jo

Struktura Organizative e 2022 Agjencisë Kombëtare të Arsimit Përmesit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAPPK)



Activate Windows
Go to Settings to activate Windows.

AKAFPK | Programi i transparencës

2 Struktura e Përgave AKAFPK

Not secure | https://www.akafp.gov.al/transparenca/akafpk/2/Struktura_e_Pergave_AKAFPK.pdf

Read aloud

3 of 5

SKEMA 2

ORGANIKA E AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1 DREJTORI PËRÇHTHSHËM	H-h	1
2 DREJTORIA E PROFESIONVE DHE KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE		9
DREJTOR	H-a	1
2.1 SEKTORI I PROFESIONVE		3
PËRQI THËS SEKTORI	H-a1	1
SPECIALISTI	TV-a	2
2.2 SEKTORI I KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE		6
PËRQI THËS SEKTORI	H-a1	1
SPECIALISTI	TV-a	5
3 DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE OPRUESVE TË APT		9
DREJTOR	H-a	1
3.1 SEKTORI I HARTIMIT TË KURRIKULAVE DHE MATERIALIVE MBËSHTETËSËS		6
PËRQI THËS SEKTORI	H-a1	1

Page | 1/10

Activity Monitor

Control Center

Windows

Type here to search

51° Partly sunny

11:04 AM

3/20/2015

AKAFPK | Programi i transparencës

2_Funksionet_dhe_detyrat_e_AKAFPK

Not secure https://www.akafp.gov.al/transparencja/Kurra_2/3_funksionet_dhe_detyrat_e_AKAFPK.pdf

Read aloud 2 of 3

Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Funksionet dhe detyrat e AKAFPK-së janë:

- a) harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, përfaqësuesit e sektorëve ekonomikë etj;
- b) harton dhe rishikon Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale për nivelet 2-5 të KSHK-së;
- c) harton dhe rishikon standardet e profesioneve;

- ç) harton dhe rishikon standardet e kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KSHK në terma të rezultateve të të nxënësve si dhe të standardeve të vlerësimit për kualifikimet profesionale;
- d) këshillohet me palë të interesuara për zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin e procedurave për përfshirjen e kualifikimeve në KSHK;
- dh) propozon ndryshimet në kritere dhe procedurën për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve profesionale, që përfshihen në KSHK;
- e) ndjek procedurat për vlefshmërinë e cilësisë së kualifikimeve, pjesë e KSHK-së, në bashkëpunim me komitetet sektoriale;
- ë) harton dhe rishikon programet (kurrikulat) kombëtare për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK si dhe programet e kurseve të unifikuara të formimit profesional publik;
- f) monitoron zbatimin e standardeve dhe programeve (kurrikulave) kombëtare nga institucionet publike ofruese të AFP-së;
- g) përcakton kriteret e vlerësimit dhe të çertifikimit të nxënësve e kursantëve në sistemin e AFP-së.

Activate Windows
Go to Settings to activate Windows.

Type here to search

51° Partly sunny 11:05 AM 2/22/2023

AKAFPK Programi i Trasparencës

4.Ejvis_Gishit_Detyrat.pdf

https://www.akafp.gov.al/transparencja/Kultura_e/A_Ejvis_Gishit_Detyrat.pdf

Read aloud

1 of 2

CV

Ejvis Gishit (Sbehi) mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) që nga muaji shkurt 2018. Prej 1 marsit 2007, ka ushtruar detyrën e Përgjegjës së Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale pranë AKAFPK-së.

Ajo është diplomuar për Menaxhim në vitin 1997 në Universitetin e Tiranës. Ka përfunduar Master në "Business Trainer and Consultant", organizuar në kuadrim e Paktit të Stabilitetit në Tiranë-Gjermani, si dhe master në "Financë – Menaxhim Bankë", Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Znj. Gishit mban titullin doktore shkencash.

Prej më se 5 vitesh, është anëtare e Bordit Këshillimor të Komizës Europiane të Kualifikimeve në Bruksel. Aktualisht është bashkëkryetare e Task Forcës për Zhvillimin dhe Zbatimin e Komizës Shqiptare të Kualifikimeve, ku ka qenë anëtare prej më se 6 vitesh.

Është angazhuar prej 20 vitesh si lektore me kohë të pjesshme në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës, dhe mbi 4 vite si lektore me kohë të pjesshme në fushën e njohurive ekonomike në Universitetin e Sportit të Tiranës.

Gjatë karrierës së saj znj. Ejvis Gishit ka zhvilluar trajnime të ndryshme duke përfunduar eksperiencë dhe duke asistuar në projekte kombëtare e ndërkombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional. Ajo është eksperte lokale dhe trajnere kombëtare e ndërkombëtare e certifikuar brenda dhe jashtë vendit në fushën e AFP.

Është autore dhe bashkautore e dhjetëra publikimeve kombëtare e ndërkombëtare si: studime, strategji kombëtare, referenca, botime e artikuj.

Nr.	AKAFPK	Arsimi dhe kualifikimet e drejtuesve/CV	Detyrat funksionale
1	Drejtor i Përgjithshëm	Ejvis Gishit (CV)	Bën organizimin, administrimin dhe drejtimin e veprimtarisë së AKAFPK-së, duke zbatuar politika efektive në menaxhimin e burimeve njerëzore e financiare dhe mirëfunksionimin e përgjithshëm të AKAFPK-së në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe veçanërisht legjislacionin për arsimin dhe formimin profesional dhe Komizën Shqiptare të Kualifikimeve.

DETYRAT KRYESORE

1. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi dhe siguron arritjen e rezultateve në kohë dhe me cilësi, sipas

Type here to search

50°F Mostly sunny

11:05 AM 3/28/2018

File Home View Kuvendi i Rejionit (Protected View) - Word (Product Activation Failed)

PROTECTED... Be careful—files from the Internet can contain viruses. Unless you need to edit, it's safer to stay in Protected View. Enable Editing

- Legislacion ndërkombëtar
- Legislacion kombëtar:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"

Ligji nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"

Ligji nr.9367 datë 07.04.2005, "Për parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike, i ndryshuar.

Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike"

Ligji nr. 119/2014 " Për të drejtën e informimit"

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar

Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar

Ligji nr. 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë"

Ligji nr. 23/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për Kormizën Shqiptare të Kualifikimeve"

Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"

Activate Windows
Go to Settings to activate Windows.

Type here to search

Earnings, upcoming

1:07 AM
3/23/2023

Urdhër nr 220, datë 16.09.2020 për miratimin e rregulorës "për zbatimin e praktikave profesionale në biznes në kuadër të ndjekjes së programeve të afpse në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional"

Udhëzim nr 128, datë 6.7.2021 për miratimin e "Rregulorës për standartet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional"

Udhëzimi nr 18 datë 6.7.2021

Udhëzimi nr 36 datë 21.11.2018

Urdhër emerimi KAKAFP

Vendim nr 729 datë 12.12.2018

Urdhër i ndërprejes së mësimit në ofruesit e AFP 2 javë

Udhëzim nr 14 datë 27.05.2021

Udhëzim nr 16 datë 8.5.2018

Udhëzim nr 28 datë 30.07.2018 "Mbi kriteret për pjesëmarrjen, organizimin dhe funksionimin e bordit drejtues të ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional"

Urdhër i përbashkët nr 71 datë 26.02.2020 për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2020-2021 në sistemin arsimor parauniversitar

Udhëzim nr 26, dt. 30.07.2018, "Për katalogun kombëtar të kualifikimeve profesionale"

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Artësive"

KERKO

Categories

ARTIS	(1)
KATEGORI	(1)
SHKOLLAR	(1)
SHKOLLOR	(1)
AFPE	(1)
VERIFIKIM	(1)
VERIFIKIM	(1)

Latest Posts

No results found.

Upcoming Events

No results found.

Our Photos

AKAFPK | Baza Ligjore

Not Secure | https://www.akafp.gov.al/trash/eshu/baza_ligjore/

Kryefaqe | Rrëz Nesh | Profesione | Kualifikimet Profesionale | Dokumente Kurrikulare | Vlerësim dhe Certifikimi | Kualifikimi i mesindhësve | EFALE

Projekti EU/AGENDA for AL | Programi i Transparencës | EQF referencing of AQF | Komitete Sektoriale

UDHËZIM Nr. 14, datë 27.5.2019 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRGATITJEN DHE LËSHIMIN E KARTËS SË STUDENTIT

URDHËR I PËRBASHKËT NR. 64, DATË 30.03.2021 "PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT"

LIGJ Nr. 69/2012 PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

LIGJ Nr. 80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Inventory and Analysis of Qualifications in Albania

Vendim nr 428 datë 26.06.2019

vendim-2019-06-26-427

vendim-2019-06-26-426

Urdhër nr 99 datë 25.5.2021 " Për miratimin e katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale"

Urdhër i përbashkët Nr 22, datë 28.01.2020 "Për disa ndryshime në urdhërin e përbashkët për ngritjen e Task Forcës për zhvillimin dhe zbatimin e mëtejshëm të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve"

Udhëzim i përbashkët i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 9.7.2015

Udhëzues praktik për hartimin e testit on line në zbatim të Udhëzimit nr 18, datë 08.05.2020

UDHËZIM Nr. 18, datë 8.5. 2020 PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT, VLERËSIMIN E NXËNËSVE, PROVIMET PËRFUNDIMTARE DHE MBYLLJEN E VITIT SHKOLLOR 2019-2020, NË SHKOLLAT PROFESIONALE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE, NË KUSHTET E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA E COVID-19

FEBRUARY 2023 (13)

JANUARY 2023 (8)

DECEMBER 2022 (2)

NOVEMBER 2022 (13)

OCTOBER 2022 (9)

SEPTEMBER 2022 (9)

AUGUST 2022 (5)

JULY 2022 (9)

JUNE 2022 (13)

MAY 2022 (12)

APRIL 2022 (28)

MARCH 2022 (0)

FEBRUARY 2022 (14)

JANUARY 2022 (10)

DECEMBER 2021 (3)

NOVEMBER 2021 (16)

OCTOBER 2021 (20)

SEPTEMBER 2021 (9)

JUNE 2021 (5)

MAY 2021 (5)

APRIL 2021 (18)

MARCH 2021 (27)

FEBRUARY 2021 (9)

11:01 AM 1/20/2023

AKAFPK | Beza Ligjore x Untitled x +

Not secure | https://www.akafp.gov.al/

Kryeqendra | Rrëthi Nesh | Profesionelet | Kualifikimet Profesionale | Dokumentet Kurrikulare | Vlerësimi dhe Certifikimi | Kualifikimi i mesimdhëseve | EFALE

Projekti EU/AGENDA for All | Programi i Transparencës | AQF - referencing of AQF | Komitete Sektoriale

UDHËZIM Nr. 18, datë 8.5.2020 PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT, VLERËSIMIN E NXËNËSVE, PROVIMET PËRFUNDIMTARE DHE MBYLLJEN E VITIT SHKOLLOR 2019–2020, NË SHKOLLAT PROFESIONALE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE, NË KUSHTET E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE TË SHKAKTUAR NGA PANDEMIA E COVID-19

Udhëzimi 15 datë 26.04.2019, Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP

Udhëzimi nr 16 datë 26.04.2019, Për llojet dhe procedurat e certifikimit

Ligji Nr. 23/2018 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 247, DATË 4.3.2010, "PËRKORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE"

Ligji nr 15/2017 dt 16.02.2017 për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë

VENDIM Nr. 514, datë 20.09.2017 Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP)

VKM nr. 673, datë 16 tetor 2019 "Per organizimin e AKAFPK"

LIGJ Nr 10 247, datë 4.3.2010 PER KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE

LIGJ Nr. 63/2014 PER DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 8972, DATE 29.3.2002, "PER ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NE REPUBLIKEN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

RREGULLORE E BRENDSHME PËR PËRZGJEDHJEN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM TË AKAFPK-SË

APRIL 2021 (16)

MARCH 2021 (21)

FEBRUARY 2021 (9)

JANUARY 2021 (11)

DECEMBER 2020 (1)

NOVEMBER 2020 (11)

OCTOBER 2020 (12)

SEPTEMBER 2020 (9)

AUGUST 2020 (6)

JULY 2020 (9)

JUNE 2020 (14)

MAY 2020 (5)

APRIL 2020 (4)

MARCH 2020 (13)

FEBRUARY 2020 (10)

JANUARY 2020 (5)

DECEMBER 2019 (1)

NOVEMBER 2019 (8)

OCTOBER 2019 (12)

SEPTEMBER 2019 (12)

AUGUST 2019 (5)

JULY 2019 (3)


JUNE 2019 (0)

Type here to search

50°F, Mostly sunny 11:00 AM 3/29/2022

Programi i Transparencës Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve AKAFPK		
Rreth autoritetit	Kyçet ligjor mujaltaktor Këshillë e pava	E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Mekanzmat kontrollues dhe monitorues që vepojnë mbi AKAFPK	Informacion mbi burimet dhe të dhënat financiare të AKAFPK	Informacioni për procedurat e prokurimit/procedurat kontraktuale të kontraktantëve të publikë privat
Shërbimet që ofrohen nga AKAFPK	Procedurat mekanizmat për të ofruar mendime lidhur me procesin e hartimit të aktit ligjor/politikeve publike apo në lidhje me dallimet e funksionimit të AKAFPK	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, listat dhe format e dokumentacionit
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Nelimita shqetësues/interveksione të dhëna nga AKAFPK	Informacione/dokumente që kërkohen më shpejt dhe ato që gjëkohen të dorëshme për problem nga AKAFPK

Koordinatori: Aida Hoxha
E-mail: aida.hoxha@akafp.gov.al
Adresa: Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kat i tretë, Tiranë
Orari i punës: E hënë – E enjte 08.00-16.30 / E premte 08.00 – 14.00
Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
[Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim](#)
[Modeli Format Ankese](#)
[Modeli Kerkese per informim](#)
[Modeli Format Ankese Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim](#)



DREJTA PËR INFORMIM

Shkarko Formularin e Kërkesës!

Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

• Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëntrajtet dokumenti: origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formatin ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

• Kërkesa për informim bëhet me shkruar dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe përshkrimin e tij. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

1. emrin dhe adresën e kërkuarit;
2. adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
3. përshkrimin e informacionit që kërkohet;
4. formatin në të cilin preferohet informacioni;
5. çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

• Çdo person, kur qmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në trupën administrative pranë Zyres së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

• Ankimi administrativ pranë Zyres së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

1. ankuesi ka marrë njëpftim për refuzimin e informacionit;
2. ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

